

SHPRESA VINCA — TUDA
(1939—1983)



Shpresa Tuda lindi në fshatin Veleshtë, afër Strugës. Në vendlindje kreu shkollën fillore. Mandej kreu shkollën normale në Ferizaj, SHLP dhe Fakultetin Filozofik, gjuhën dhe letërsinë shqipe në Prishtinë. Ndiqte studimet pasuniversitare në Universitetin e Prishtinës, ku i pat dhënë pjesën dërmuese të provimeve.

Shpresa Tuda punoi në arsim dhe ushqente dashuri të madhe për nxënësit. Dy veprat e saj e dëshmojnë këtë dashuri ndaj fëmijëve, sepse, pos që u janë kushtuar atyre edhe titujt përmbajnë simbolikë rinie.

Dashurinë dhe përkushtimin tjetër të Shpresës e konsiderojmë krijimtarinë: krijimtarinë origjinale poetike dhe mbledhjen e studimin e folklorit shqiptar.

Shpresa më se një dekadë bashkëpunoi me Institutin Albanologjik të Prishtinës, duke sjellë material të çmueshëm për Degën e Folklorit dhe për atë të Etnografisë. Materialet e saj janë shënuar me përkushtim dhe përcillen me shënime të cilat i shoqërojnë njësitë folklorike dhe ritet e ndryshme popullore.

Në krijimtarinë origjinale poetike Shpresa Tuda la përmbledhjen e poezive për fëmijë, të cilën e botoi Klubi letrar „De Rada” i Ferizajt më 1978, Jeta jonë është pranverë. Ndërsa folklorit tonë ajo i la, duke u bazuar në këto që kemi në Arkivin e Institutit, 472 njësi folklorike të mbledhura në rrethinën e Strugës, kryesisht këngë lirike. Ajo botoi një përmbledhje këngësh të fëmijëve, të cilat i ka shënuar në rrethinën e Strugës dhe të Ferizajt.

Këngët popullore të fëmijëve i botoi Klubi letrar „De Rada” në Ferizaj në vitin 1979. Ato mbanin një tituli simpatik që përshkohej me një simbolikë, që pasqyron rini dhe dashuri „O ju, moj lule”. Ajo i botoi tri

punime në revistën tonë „Gjurmime albanologjike-Folklor dhe etnologji” dhe një punim „Të dhëna etnografike lidhur me shtëpinë në Veleshtë të Strugës” për përmbledhjen me punime nga kjo Degë, i cili nga shumë autorë do të botojë veprën e rëndësishme „Transhëgimia dhe transformimi i kulturës popullore”

Nga kjo veprimtari e Shpresa Tudës buron optimizmi për punë dhe për jetë. Dy titujt e veprave të saj shprehin entuziazmin që e shoqëron njeriun, i cili do t'i mposhtë pengesat në rrugën e jetës dhe të arrijë në cakun që synon. Vetë fakti se Shpresa që nga shkolla fillore, pothuaj, arrin të ashkollohet me korrespondencë deri në studimet pasuniversitare, do të thotë se kishte vullnet të fortë dhe dashuri të çiltër e të pashoqe për dituri dhe për arsimim.

Mbi të gjitha, e për këtë arsye i takon edhe ky vendnderim në revistën tonë, Shpresa Tudën e çmojmë për kontributin që dha në mbledhjen e letërsisë popullore, për bashkëpunimin me revistën, për pjesëmarrjen në tubimet tona shkencore dhe, për përmbledhjen me këngë popullore të fëmijëve „O ju, moj lule”.

Natyrisht, është e kuptueshme se puna e Shpresës në lëmin e folklorit nuk përfundon me kaq (mund të ketë njësi të mbledhura në dosjet e saj në shtëpi, mund të ketë punime të shkruara me çështje folklorike e etnografike, të cilat shpresojmë se do të arrijnë në Institutin tonë). Qysh para disa vitesh ajo përgatiti për botim përmbledhjen me materiale folklorike „Struga në Këngët popullore”, të cilën ia pat dorëzuar Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore në Prishtinë. Nuk ka dyshim se botimi i këtij libri do të ishte një kontribut i çmueshëm për njohjen e folklorit të kësaj treve, veçanërisht të lirikës popullore.

Me rastin e botimit të përmbledhjes së saj me këngë popullore të fëmijëve, pata konstatuar:

„Janë të rralla femrat që merren me studimin e folkloristikës, por shumë më i vogël është numri i atyre që merren me mbledhjen e letërsisë popullore. Vetë natyra e punës në terren është mjaft e vështirë për femrat-nëna. Shpresa Tuda është njëra ndër ato mbledhëse të zellshme të letërsisë popullore, e cila vite me radhë i ka sjellë Institutit Albanologjik të Prishtinës material të çmueshëm folklorik dhe etnografik.”

Vërtet, në viset tona kemi problem të gjejmë subjekte femra e lë më bashkëpunëtoresh. Po Shpresa kishte filluar me vullnet të madh dhe prej punës së saj si mbledhëse mund të dalë një vëllim i denjë këngësh popullore lirike.

Këngët e mbledhura, këngët e shënuara, ajo vazhdimisht i ka shoqëruar me shënime të nevojshme që janë të domosdoshme si të dhëna përcjellëse shkencore: shënimet për subjektet, shënimet për këngët, shënimet për kohën kur këndohen, shënimet se a shoqërohen me valle apo me ndonjë ritual tjetër. Me shënime të tilla janë përcjellë tri punime të saj në revistën „Gjurmime albanologjike-Folklor dhe etnologji” si dhe këngët në përmbledhjen „O ju, moj lule”. Me shënime të tilla ajo i jep ndihmesë modeste folkloristikës, etnografisë dhe mitologjisë. Ato të dhëna i takojnë një regjioni pak të largët, i cili ka edhe specifikat e veta të krijimtarisë popullore,

të kulturës popullore në përgjithësi, ka kushte karakteristike të rrethit ku krijohet ajo kulturë.

Me tubëzën e këngëve popullore për fëmijë, Shpresa Tuda i dha kontribut letërsisë popullore duke hapur një shteg më të afërm për njohjen më të mirë të kësaj poezie dhe, „O ju, moj lule” filloi jetën midis veprave të ngjashme.

Në blejt me materiale folklorike që i botoi Instituti Albanologjik siç janë: Balada dhe legjenda (1974), Këngë dashurie I, (1979), Këngë dasme I (1980), Këngë të ndryshme popullore (1982), Ninulla (1982), Përralla I (1979), Përralla II (1982), Shpresa ka një pjesëmarrje të dukshme me materialet e saj që përfaqësohen me 87 njësi — kjo do të thotë se një e pesta e materialit që ajo ka mbledhë është botuar çka rrallë ndodh me mbledhësit e tjerë. Materialet e saj do të botohen edhe në blenjtë e tjerë, por do konstatuar se edhe Arkivi është më i pasur me njësitë e një punëtoreje të tillë.

Mund të themi me bindje se në këtë rrugë të fillimit të zhvillimit të Institutit tonë, që e kanë ndihmuar njaft bashkëpunëtorët e jashtëm, kemi arsye që Shpresa Tudën ta kujtojmë pas vdekjes dhe t'i shfaqim falënderimin dhe respektin tonë për kontributin e dhënë kulturës së popullit.

RRUSTEM BERISHA

The first of the... the second of the... the third of the... the fourth of the... the fifth of the... the sixth of the... the seventh of the... the eighth of the... the ninth of the... the tenth of the...

The first of the... the second of the... the third of the... the fourth of the... the fifth of the... the sixth of the... the seventh of the... the eighth of the... the ninth of the... the tenth of the...

The first of the... the second of the... the third of the... the fourth of the... the fifth of the... the sixth of the... the seventh of the... the eighth of the... the ninth of the... the tenth of the...

The first of the... the second of the... the third of the... the fourth of the... the fifth of the... the sixth of the... the seventh of the... the eighth of the... the ninth of the... the tenth of the...

The first of the... the second of the... the third of the... the fourth of the... the fifth of the... the sixth of the... the seventh of the... the eighth of the... the ninth of the... the tenth of the...

The first of the... the second of the... the third of the... the fourth of the... the fifth of the... the sixth of the... the seventh of the... the eighth of the... the ninth of the... the tenth of the...

The first of the... the second of the... the third of the... the fourth of the... the fifth of the... the sixth of the... the seventh of the... the eighth of the... the ninth of the... the tenth of the...